

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

DATE: 09.10.2020.

PJESA I E KONTRATËS:

KONTRATA

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.T.SH "TINI"-Prizren, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

Rregullimi i fushës së Sportit "Fetah Sylejmani" në Dragash (projekt dy vjeçar)

me numër identifikues: 621-20-4941-5-2-1, dhe nr. të mbrendshëm 621-2020-118-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Rregullimi i fushës së Sportit "Fetah Sylejmani" në Dragash (projekt dy vjeçar)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **31,533.52 €**; (tridhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e tre Euro e pesëdhjetë e dy cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetohet", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [[angleze][shqipe][serbe]² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	09.10.2020.
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	N.T.SH "TINI"-Prizren
Pozita:	menagjer
Nënshkrimi:	
Data:	09.10.2020.
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2

Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3

Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të

njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 86 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i

urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohej për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatoheshin, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndër marrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

10/12/2019
08:51/2019

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK deri me 05/11/2021
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 2 (Dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 05/10/2021
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.

		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues. Menagjer I kontrates nga AK eshte: Vloran Cenaj Menagjer I projektit nga AK eshte: Florim Krasniqi Menagjer I projektit nga OE eshte: Leonard Sinani
Pagesat	24.1	Ky projekt eshte dy vjeqar: Pagesa do te behet: Viti-2020: 20 000,00 euro Viti-2021: 11 533.52 euro
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10 % e vleres se kontrates per periudhen një vjeqare
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Tini
Fetah Gjylgjorani

Rregullimi i fushës së Sportit "Fetah Sylejmani" në Dragash (projekt dy vjeçar)					
PARAMASA E PARALLOGARIA					
PUNËT NE TERENIN SPORTIV					
Kushle të përgjithshme:					
Përshkrimi i punëve. Në përpueshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.					
Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Për në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (prevenitive) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shërbim gjatë fazës së punimeve. Matenat nuk duhet të dalin jashtë rrethosjes së punishtës.					
Punishja të rrethohet me tabela prej llamarinë dhe me konstrukcion të përfunduar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashihet edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve eksistuese të cilat ngelen në shërbim (funktion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.					
Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektantit.					
Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.					
Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vuajtjen në vepër të materialeve për secilin pozicion					
PUNIMET PREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1.1	Shënimi i kantient me shenja rreziku në zonat ku do të punohet të terrenit sportiv sipas projektit detaj. gjatë kohës sa zgjatën punimet si dhe Furnizimi me material dhe pregaditja e punimi i rrethosjes së punishtës me tabela prej llamarinës dhe me konstrukcion të përfunduar mirë në tokë. Lartësia e rrethosjes h=2.0 m Llog në m²	m²	70.00	0.30	21.00 €
1.2	Identifikimi i instalimeve nëntokësore dhe mbikëqyrës (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rryme, instalimet telefonike dhe internetit), pëktimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit të parandalimit të dëmtimeve eventuale që mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demotim të rrjetit ekzistues pasirimin e terrenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme. Llog në m²	m²	2,100.00	0.10	210.00 €
1.3	Inçizimi gjeodezik i lokacionit ekzistues. Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet profilore ku do të punohet sipas projektit detaj gjatë kohës sa zgjatën punime. Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e punëve në vazhdimi me instrumentet gjeodezike deri sa të përfundojnë punimet. Llog në m².	m²	2,100.00	0.10	210.00 €
1.4	Instalimi i zyreve të përkohshme në punishtë (~12m²/copë) nga konteneret. Vendosija e tyre bëhet në bashkëpunim me organin mbikëqyrës. Llog në copë	copë	1.00	10.00	10.00 €
1.5	Instalimi i përkohshëm i instalimeve komunale (uji, mbeturinat, rryma me njësoor nga rrjeti, gjeneratori.) Llog në paushall.	paushall	1.00	10.00	10.00 €
1.6	Instalimi i përkohshëm i tavolinës së armirueseve (tavolina me mbules deri 15 m gjatësi) Llog në paushall.	paushall	1.00	1.00	1.00 €
Gjithesëjt punime Pregaditore:					462.00 €
PUNIMET E DEMOLIMIT					




Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
2.1	Pastrimi i terenit nga mbeturinat, e ngurta, shkurret drunje dhe rrethojave në zonat ku do të realizohen punimet. Deponimin e materialit të demoluar e cakton investitori. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rrethojave metalike dhe murit nga materiale të kombinuara në segmentet periferike. Materiali i gardheve metalike është prone e investitorit. Çmimi komplet për perimetër në m'	komplet	1	50	50.00
2.2	Dislokimi i shtyllave të rrjetit elektrik të tensionit ultë dhe atij të lartë së bashku me rrjetin e telave në shtyllën e re nga druri apo betonit me H=9.0m dhe rrjetit elektrik në pozicionin e ri të cilin e cakton organi mbikqyrës në bashkpunim me menaxhimin e përgjegjës dhe menaxherin e kontratës (deri në 10 m' dislokim). Te gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e nevojshme i bart punktyesi. Llog në copë	copë	1	300	300.00
2.3	Demolimi me kujdes i kubëzave egzistuese në terenin ku do të egzekutohet stadioni, materiali i demoluar largohet anash, në deponim të cilin e cakton investitori. Në çmim të kalkulohet komplet puna dhe materiali i nevojshëm për zhvendosje. Materiali i demoluar është prone e investitorit Çmimi komplet për sipërfaqe të demoluar. Llog m2,	m²	60	2	120.00
2.4	Demolimi me kujdes i paisjeve të egzistuese sportive ku do të egzekutohen punimet, materiali i demoluar largohet në deponim të cilin e cakton investitori. Në çmim të kalkulohet komplet puna dhe materiali i nevojshëm për zhvendosje. Materiali i demoluar është prone e investitorit. Llog në copë	copë	6	2	12.00
2.5	Gryeja, prerja dhe demolimi me kujdes i asfaltit egzistues në terenin ku do të egzekutohet stadioni, materiali i demoluar largohet në deponim të cilin e cakton investitori. Në çmim të kalkulohet komplet puna dhe materiali i nevojshëm për zhvendosje. Çmimi komplet për sipërfaqe të demoluar. Llog m2,	m²	1,035.00	0.80	828.00
2.6	Pastrimi, grumbullimi dhe ngarkimi i të gjitha mbeturinave apo gjesendeve të forta që gjenden në këtë sipërfaqe për trajtim, materialet largohen me transport në deponi legale deri në 15km, të percaktuar nga organi kompetent. Llog m2	m²	2,100.00	0.10	210.00
Gjithesëjt punime të demolimit:					1,520.00 €

PUNIMET TOKËSORE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
3.1	Gërmimi i gjerë i dheut të kategorisë III ose IV. Me makina nderimore në vendet e projektuara. Largimi i materialit të gërmuar dhe demoluar me transporte gjer në deponin të cilin e cakton investitori deri 15 km. Në këtë pozicion përfshihet edhe nivellizimi i teranit me ramjet e duhura duke përfshirë elementet tjera përcjellëse të percaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme, si dhe detajeve teknike. Llog m3	m³	58.60	2.00	117.20 €
3.2	Planifikimi dhe kompaktimi i sipërfaqeve të gryera dhe të gërmuara, para hüdhes së materialit mbushës me modul të ngjeshjes 20Mpa Llog në m2	m²	1,169.00	0.10	116.90 €
3.3	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV për hapjen e themeleve për ndërtimin e ankereve, çokles perimetrike, shtyllave të reflektoreve, themeleve të paisjeve tjera sportive. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tapërt deri në deponin e caktuar nga org mbikqyrës 15 km. Llog m3	m³	24.60	2.00	49.20 €
3.4	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimi 50Mpa, f=20 cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Llog në m3	m³	40.00	8.00	320.00 €



3.5	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyesit d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimi 70Mpa, t=10cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë Llog në m3	m³	112.50	6.00	675.00 €
3.5	Blerja, furnizimi me gjeotekstil 300 gr/mm², mbi sipërfaqen e ngjeshur të terentit. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për Llog. m²	m²	1,000.50	0.70	700.35 €
Gjithesëjt punime Demoluese , Tokësore dhe Zhavorike :					1,978.65 €
IV	PUNIMET E MURIT PERIMETRIK DHE TRIBINAVE				
	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
4.1	Gërmimi i dheut me makinen e kategorisë së III të me ngarkim dhe bartje deri në deposti (deri në 15Km). Sasia të llogaritet në gjendje natyrale. Llog. në m3	m³	20.00	2.70	54.00 €
4.2	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazos së trupit të thellët me ngjeshmëri 40MN/m2.	m³	30.00	0.10	3.00 €
4.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=15cm, si dhe ngjeshja me papuçe dhe me goditje . Llog. në m3	m³	7.50	6.00	45.00 €
4.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës rrafshuese, betonimi i themeleve të murit mbrojtës nga betoni i thjeshtë C12/15 me trashësi 5 cm, në çmim të llogaritet mirmbajtja e betonit. Punimi Sipas detajit të dhënë. Llog. në m3	m³	1.25	10.00	12.50 €
4.5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve të murit mbajtës nga betoni i armuar C25/30 , me dim 50x30 cm Në çmim llogaritet kallupimi me drasa, betonit duket shtuar shtesa aditiv për papershkrushmëri nga uji, duke vibruar dhe respektuar dhe mirmbajtja e betonit. Punimet të kryhen Sipas detajit të dhënë. Llog. në m3	m³	6.00	70.00	420.00 €
4.6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i murit mbajtës me dim sipas zgjidhjes teknike të prezentuar dhe lartësi hmes=1.5 m , dhe d=20 cm, nga betoni i armuar C25/30. Në çmim llogaritet kallupimi me drasa, si dhe betonimi duke i shtuar shtesa aditiv nga pa pershkrushmëria e ujit , vibruar dhe respektuar shtresën mbrojtëse Punimet të kryhen Sipas detajit të dhënë.	m³	18.75	70.00	1,312.50 €
	Punimi i kallupimit nga drasat me sipërfaqe të lemuara për punimin e shkallëve të fushës së sportit me dim 40/80 cm dhe d=12 cm në pjesën anësore Furnizimi, transporti, hudhja e betonit në vepër e Betonit të klasit C -25/30 , betoni duhet vibruar dhe shtuar aditiv për papershkrushmëri të ujit në çmim të parashihet edhe punimi i themeleve në pjesën e poshtme të shkallëve . Punimet të kryhen sipas standardeve dhe detaje grafike të dhëna në llogaritjen statike për punimin e murit në pjesën e poshtme të fushës së sportit. Llog. në m3.	m³	15.75	70.00	1,102.50 €
4.7	Furnizimi i hekurt ndërmor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armatures të hekurt të brinjëzuar të klasës S 400/500 , të gjitha në përputhje me llogaritjen statike sipas detaleve teknike të armimit të përfshira në projekt. Llogaritja në kg.	kg	2,687.50	0.47	1,263.13 €
Gjithesëjt punime Muri dhe tribina:					4,212.63 €
V	PUNIMET E BETONIT DHE BETONARMES				
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total




Të gjitha pozicionet e strukturave të betonit duhet të realizohen, sipas dimensioneve, dhe sipas llojit dhe klasës së betonit, dhe ale sipas dokumentacionit Teknik të projektit, llogaritjes statike dhe detajeve të armimit. Betoni për të gjithë llojet e punimeve duhet të pregaditet, transportohet, punohet, mirëmbahet dhe testohet sipas parashikimeve të përcaktuara në rregullat e zbatueshme, "Rregullat për Standardet Teknike për Beton dhe Beton të Armuar (PBAB). Të gjitha panellet (kalapet) e pjesëve të dukshme të betonit të lyhen dhe të jenë të kualitetit të lartë në mënyrë që të përmbushen edhe kriteriet e larta vizual-estetike të sipërfaqeve të betonuara. Betoni për betonimin e mureve dhe shtyllave të jashtme, prapa të cilave bëhen mbushje e argjinaturat dhe shtohet hidroizolimi vertikal me shtimin e aditivëve të papërshkueshëm nga uji. Kalapet dhe platformat, mbështetja duhet të bëhen në bazë të dimensioneve të parashikuara në mënyrë të shkathët dhe cilësore, në mënyrë që pas betonimit dhe çmonimit të punimeve të mos ndodhin as deformimi më i vogël në strukturë. Gjatë betonimit strukturat konstruktive pas ndërprerjeve të nevojshme të betonimeve, lidhja dhe vazhdimi duhet të pastrohen së pari, sipërfaqja duhet të jetë e ashpër, shpëlarja dhe pastaj të betonohet vazhdimi. Llogaritja e sasive të punimeve të kryera në të vërtetë nga njësitë e dhëna të masës (libri i ndërtimit).					
5.1	Furnizimi, transporti, dhe punimi i shtresës rrafshuese të betonit të varfër nën themelet e mureve të cokes shputave të shtyllave në gropën e rregulluar me beton të vibruar dhe me aditive për papërshkueshmëri të ujit d = 5 cm, Me C -12/15 Punimet të kryhen sipas detaje grafike të dhëna për kesi llog punimesh. Llog. në m3	m³	2.075	10	20.75
5.2	Punimi i kallupimit nga drasat për punimin e themeleve të shputave të shtyllave të ankerave të gardhit metalik, paisjeve sportive themeleve të reflektorave si dhe murin e cokes periferike të fushës së sportit .Furnizimi, transporti, hudhja e betonit në veper e Betonit të klasit C -25/30 ,betoni duhet vibruar dhe shtuar aditive për papërshkueshmëri të ujit dhe largimi i kallupimeve për punimin e murit në pjesën e poshtme dhe ate anesore të fushës së sportit. Punimet të kryhen sipas standrdeva dhe detaje grafike të dhëna në llogaritjen statike për punimin e murit në pjesën e poshtme të fushës së sportit. Llog. në m3	m³	29.05	70.00	2033.5
Gjithesëjt punime të Betonit dhe betonarmes:					2,054.25 €

VI PUNIMET E ARMIRUESEVE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
6.1	Të gjitha llojet e armaturave duhet të pastrohen nga ndryshku, balta dhe gëlqerja, prerja, lakimi dhe vendosja saktësisht sipas llogaritjes statike dhe detajeve të armaturës. Para betonimit, organi mbikqyrës duhet të kontrollojë vendosjen e saktë të armaturës. Çmimi njësi i secilit pozicion të këtyre punimeve përfshin gjithçka që është e nevojshme deri në përfundimin e së njëjtes.				
	Lloji i armaturave të përdorura janë Sipas detajeve në projekt: Armatura S-600:				
	Furnizimi, punimi, prerja, lakimi, lidhja dhe ivendosja e armaturës në kallupe si GA, RA dhe MA sipas pozicioneve të projektit dhe detajeve statike. Marmatura të tipeve GA, RA, MA Llog. në kg.	kg	1,506.00	0.45	677.70 €
Gjithesëjt punime të Armirueseve:					677.70 €

VII PUNIMET E ASFALLTIT					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
7.1	Perzierja e asfaltit (AB11, AB16; AB22, etj) me perforcues të asfaltit me përberje të fibrave të Aramidit dhe Polyolefineve (FORTA FI apo i ngjajshëm) ose material të tjera me përberje dhe karakteristika të njëjta (500 gr/1 ton asfalt).				
	Furnizimi, transporti dhe montimi i rigolave nga betoni C 30/37, me dim (20x25x10) cm duke i llogaritur të gjitha punimet e tjera të nevojshme. paraprakeDuke patur kujdes në kriterin e ramjeve gjatësore sipas dispozites së dhënë në projekt. Llog në m²	m²	88.0	7.0	616.0

7.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i bituzhavorit për nivelizimin e lules së sportit me BZH 022 mm me finisher në trashësi deri në 5 cm. Në çmim të llogaritë furnizimi dhe shtresimi i BZH 022 mm, pastrimi, larja e trupit të terrenit sportiv dhe lyerja me emulzion. Llog në m2	m²	990.0	5.0	4950.0
7.3	Furnizimi, transporti dhe shtresimi i asfaltbetonit BIT 60 AB 11, 011mm, me d= 3 cm në gjendje të ngjeshur duke e përfshirë pastrimin, larjen dhe lyerjen me emulzion. Llog në m2	m²	990.0	8.0	7920.0
Gjithsejt punime të Asfaltit:					13,486.00 €



✓
✓
✓

VIII PUNIMET E DRYNARIS (GARDHI METALIK)					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
8.1	Furnizimi, prerja, saldimi dhe punimi i rrethojës metalike sipas detallit në projekt. Lartësia e rrethojës është H=4.70 m. Në pozicion të përfshihen, ankerimet e nevojshme, saldimet, shtyllat vertikale, horizontale, mbushjen me rrjet çeliku me ndarje katrore çdo 12.5 cm Ø4.6 në të dy drejtimet të kufizuara me profila L, pllakat lidhëse mbyllesat përfundimtare të profileve metalike, lyerëja me një ngjyrë antikorozion dhe dy shtresa finale nuanca e gjelbër. Llogaria në m² të rrethojës. Rrethoja punohet sipas detallit teknik në përshkrimin teknik.	m²	623.240	2.670	1,664.05
8.2	Furnizimi, prerja, saldimi dhe vendosja e 2 dyerve hyrëse një krishe me dimensione (160)x205 cm, të inkuadruar në rrethojën nga materiali dhe dizajni i njëjtë si i rrethojës, në çmim të llogaritës ngjyrosja dhe mekanizimi për hapje dhe mbyllje. Llog në m2.	m²	6.560	45.000	295.20
Gjithesëjt punime të Drynaris (Gardhit metalik):					1,959.25 €

IX PUNIMET E PAJISJET E FUSHËS SPORTIT					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
9.1	Punimi dhe montimi i shtyllave për tabelë të basketbollit me diametër Ø125mm duke llogaritur edhe përforcimet në bazament me pllaka të hekurit 600 x 600 x 20mm, ankonimin e bulonave Ø20mm gjatësi 80cm vendosjen-saldimin e pllakave përforcuese 4 x 200 x 320 x 20mm dhe lartësi 500mm. Vërejtje: Në çmim Për shtylla duhet të punohet edhe bazamenti nga betoni i klasit C-25/20 me dim. 90 x 90 x 80cm duke llogaritur edhe tamponin në bazament me trashësi t=20cm. dhe dy themele 30 x 50 x 50 cm Kërkë sipas skicës së bashkangjitur. Llog në komplet	komplet	2.00	80.00	160.00 €
9.2	Blerja dhe montimi i tabelës së basketbollit me dim. 180 x 120cm nga druri i lameluar dhe ngjyrosur me ngjyrë speciale (rezistues ndaj kushteve klimatike), duke llogaritur edhe vendosjen e rrethit të basketbollit nga hekuri me gjithë rrjetë. Llog në komplet	komplet	2.00	120.00	240.00 €
9.3	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave të futbollit të vogël me diametër Ø80mm të cilat duhet të jenë të paisura me rrjetë. Shtyllat duhet të jenë konform standardeve dhe të njëjta duhet të fiksohen në themele nga betoni-asfalt (anëkim fleksibil me bulona). Llog në komplet	komplet	2.00	170.00	340.00 €
9.4	Furnizimi dhe vendosja e rrjetës së voleybollit me të gjitha pjesët e nevojshme për vendosje në terrenin sportive (shtylla dhe elementet lidhëse, Konstruksioni i shtyllave të rrjetës të voleybollit jenë mobilë, konform normave dhe standardeve për kështj sporti Llog në komplet	komplet	1.00	70.00	70.00 €
Gjithesëjt punime të pajisjeve sportive:					810.00 €

X PUNIMET E SHENJIZIMIT TË SPORTEVE TË VOGLA					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
	Shënim i terrenit sipas projektit, me linjat 5 cm të gjera, përveç një linje e golit 8 cm të gjerë. Terenet janë shënuar me ngjyra të ndryshme për nevojat e dy ekipeve të basketbollit, një fushë hendbollit, një fushë futbollit dhe një fushë të voleybollit. Fusha e hendbollit (katran për futbollin) është shënuar me Ngjyrë cilësore për këtë qëllim në dy shtresa, me ton të verdhë RAL 1026. Fushat e Basketbollit është e shënuar me ngjyrë cilësore për këtë qëllim në dy shtresa, me ton të kuq RAL 1026. Të dyja e ndeshjes së voleybollit shënohen me ngjyra cilësore për këtë qëllim në dy shtresa, në një ton të bardhë.				

10.1	Furnizimi me material si dhe punimi i vijave për futboll, hendboll, basketboll, dhe volejboll, me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së organit mbikqyrës. Pozicioni përfshinë të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional, të gjitha materialet duhet të plotësojnë standardet teknike evropiane të parapara për këtë aktivitet. Llog. në m'			
	Shenjëzimi i vijave të terrenit sportiv për basket	m'	136.92	1.00
	Shenjëzimi i vijave të terrenit sportiv për futboll	m'	172.72	1.00
	Shenjëzimi i vijave të terrenit sportiv për hendboll	m'	50.80	1.00
	Shenjëzimi i vijave të terrenit sportiv për volejboll	m'	81.00	0.50
Gjithsejt punimet e shenjëzimeve të sporteve të vogla :			400.94	

XI PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE TË NDRIQIMIT

Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
	Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.				
	Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këto mënyra duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preveniva) hapësirë në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtës. Punishtëja të rrethohet me tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përfunduar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikujtjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve. Për qdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikqyrës dhe projektanti. Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjashme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO. Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion				

11.1 NDRIQIMI I FUSHES SË SPORTEVE TË VOGLA					
Nr	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
11.1.1	Gërmimi i dheut të kategorisë së III - IV me vegla dorë si dhe mbulimi i kanalit 70 x 30 cm neper të cilën duhet të shtrihet kablo kryesore e furnizimit nga rrjeti publik deri tek KSH, shtrirja e shiritit sinjalizues paralajmruar në tërë gjatësinë e kanalit. Kablo furnizuese nga duhet të mbulohet me me rërë të imet deri në 15 cm mbi kablo. Llog. në m	m	50.00	2.00	100.00 €
11.1.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së III - IV me vegla dorë si dhe mbulimi i kanalit 50 x 30 cm neper të cilën duhet të shtrihet kablo energjetike e furnizimit nga KSH deri tek trupat ndriqes, shtrirja e shiritit sinjalizues paralajmruar në tërë gjatësinë e kanalit. Kablo furnizuese nga duhet të mbulohet me me rërë të imet deri në 10 cm mbi kablo.	m	50.00	4.00	200.00 €
11.1.3	Gërmimi i dheut të kategorisë së III - IV me vegla dorë si dhe mbulimi i kanalit për shtrirjen e gypit PVC dhe kablit furnizues të ndriqim 70 x 30 cm. Kablo duhet të mbulohet me me rërë të imet deri në 15 cm mbi kablo. Llog. në m	m	50.00	4.00	200.00 €
11.1.4	Furnizimi transporti dhe vendosja e trupave ndriquese REFLEKTOREVE të tipit LED 183VV, IP65. Montimi i tyre të bëhet në sipas dispozitës së dhënë në projekt në lartësinë 8m. Llog. në copë	cope	6.00	50.00	300.00 €
11.1.5	Furnizimi transporti dhe vendosja e kabllos furnizuese të tipit NYY-J(AI) 5x16 mm², nga rrjeti publik deri tek KSHM. Llog. në m	m	50.00	6.00	300.00 €

11.1.6	Furnizimi transporti dhe vendosja e kabllos furnizuese të tipit NYY-J(AI) 5x10 mm², nga KSHM deri te trupat ndriqes. Llog. në m	m	160.00	4.20	672.00 €
11.1.7	Porosia dhe vendosja e gypit te brinjëzuar PVC Ø50. Llog në m	m	50.00	2.00	100.00 €
11.1.8	Porosia dhe vendosja e gypit te brinjëzuar PVC Ø35. Llog në m	m	150.00	2.00	300.00 €
11.1.9	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues ..Llog në m	m	177.00	0.10	17.70 €
11.1.10	Furnizimi transporti dhe vendosja e sondave per tokezim me gjatesi 2m. Sondat duhet te vendosen ne fund te secilit qark te ndriqimit. Llog në m	m	3.00	10.00	30.00 €
11.1.11	Furnizimi transporti dhe montimi i Kuadrit shpërndarës Mates IP 40 komplet me pajisjet e duhura elektrike duke perfshire: montimin e njehesorit elektrik, Reles kohore, siguresave, kontaktoreve , FID-ve dhe paisjeve te tjera sipas skemes njeopolare te paraqitur ne pjesen grafike. Llog në copë	copë	1.00	170.00	170.00 €
Gjithesëjt punimet e ndriqimit të sportive të vogla :					2,389.70 €

XII PUNËT E INSTALIMEVE TË KANALIZIMEVE ATMOSFERIKE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
12.1	Germimi i dheut te kategoris se III- IV-të me thellësi mesatare si dhe shtrija e shiritit sinjalizues paralajmrues ne tere gjatesin e kanalit. nga duhet mbulimi i kanalit të gypave e kanalizimit me 1.0 m'x0.65m' si dhe largimi i dheut deri ne deponin e qytetit 15 km. Llog në m³	m³	36.00	4.00	144.00 €
12.2	Furnizimi, transporti dhe hedhja e rrës në fund të kanalit mbi të cilën shtrihen gypat e kanalizimit të ujit me t=25cm dhe - logaritmet në m'	m³	10.25	4.00	41.00 €
12.3	Furnizimi transporti si dhe hudhja ne shtresa 20-30 cm e zhavorit (0-31.5) me ngjeshje. Llog. Në m³	m³	10.00	5.00	50.00 €
12.4	Punimi i pusetave të kanalizimit nga gypat e parafabrikuar betonarme 1xØ800 dhe konusin ne kok me kapaku nga materiali kompozit per pesha 40ton.Ne qmim te kalkulohet komplet puseta dhe bazamenti betonarme. Llog. ne copë	copë	2.00	50.00	100.00 €
12.5	Furnizimi transporti si dhe montimi i gypave i PE PVC me elemente tjera percjellëse fazonike unazore. Llog në m'				
	Gyp PVC Ø 75 mm	m'	10.00	1.00	10.00 €
	Gyp PVC Ø 110 mm	m'	35.00	1.00	35.00 €
	Gyp PVC Ø 125 mm	m'	70.00	1.00	70.00 €
	Gyp PVC Ø 160 mm	m'	25.00	2.00	50.00 €
12.6	Furnizimi transporti si dhe vendosja e ujëmbledhësit horizontal me kapak metalik . Në qmim te parashihet , vendosja me stabilizues bazament te betonit . Komplet për copë.	copë	14.00	25.00	350.00 €
Gjithesëjt punimet e kanalizimit Atmosferike të sportive të vogla :					850.00 €

XII PUNËT E INSTALIMEVE TË UJËSJELLESIT PËR LARJE (PASTRIME) DHE VADITJE	
--	--

Punime parapregaditura dhe ato tokësore					
12.1	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Përgatitja e terrenit. Pastrimi dhe Shënimi i trases. Për germim. Llog në m'	m;	50.00	0.50	25.00 €
2	Germimi me makinë dhe pjesërisht manualisht në tokën e kategorisë së III -IV- me gjerësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit, shiqo detalin e prerjes tërthore) dhe thellësi minimale h=1,20 m dhe gjerësi 0.80m. Hapja e kanalit duhet të bëhet me saktësi ±3 cm . Dheu i tepër i germuar me transport deri në 15 km..Llog në m³.				

74


	me makinë 90 %	m ²	21.60	2.00	43.20 €
	me vegla dore manualisht 10%	m ²	2.40	3.00	7.20 €
3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i rrerës nën, rreth dhe mbi gypat e ujësjetës me trashësi d=30cm fraksion 0-4 mm Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%Llog. Në m3.	m ³	4.50	5.00	22.50 €
4	Mbulimi dhe planifikimi i kanalit me material e germuar dhe ngjeshja në shtresa 25cm deri në kuotën e terrenit.Llog.në m3	m ³	19.50	1.00	19.50 €
5	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar (tepërt) në deponi të percaktuar nga investitori ose në vendin ku e cakton organi mbikqyres deri L=15 km.Llog në m3	m ³	5.00	2.00	10.00 €
Gjithësejt Punime parapregaditura dhe ato tokësore:					127.40 €

12.2 Punime e pusetave hidrantike për ujitje dhe pastrim (Larje)					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Ndërtimi i pusetave hidranteve për pastrimin e terrenit duke marrë parasysh edhe ndërtimin e pusetave nga beton-arme, punët latuese, kapakun e pusetes, etj. Dimensionet dhe gjeometria e pusetave të përshatet me montimin e pjesëve fazonike. Në çmim duhet të llogaritet edhe paisja hidrantike me pjesët e nevojshme fazonike si dhe Gypi i ujësjetës për vadije DN-20mm, L=50m'. Llog. në copë	copë	1.00	50.00	50.00 €
2	Furnizimi Punimi dhe instalimi i një lavabo nga materiali i noxhit me kater qeshme .në një mbështetje stabile nga muri me një mbulesë deri në nallësi 220 m.Llog në komplet	komplet	1.00	55.00	55.00 €
3	Punët instaluese dhe montuese.Furnizimi, transporti dhe instalimi i tubave PE, RC 100. Montimi bëhet me saldim ballorë (sislemi elektro fuziv)..PE 100, DN 32 mm, PE- RC, PN 10 bar. Llog në m;	m	50.00	10.00	500.00 €
Punime e pusetave hidrantike për ujitje dhe pastrim (Larje):					605.00 €

Gjithësejt Punime të instalimeve të ujësjetës për ujitje dhe pastrim (Larje):	732.40 €
---	----------

Nr.	REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM	
I	PUNIMET PREGADITORE	462.00 €
II	PUNIMET DEMOLUESE	1,520.00 €
III	PUNIMET TOKËSORE	1,978.65 €
III	PUNIMET E MURIT PERIMETRIK DHE TRIBINAVE	4,212.63 €
IV	PUNIMET E BETONIT DHE BETONARMES	2,054.25 €
V	PUNIMET E ARMIRUESEVE	677.70 €
VI	PUNIMET E ASFALLTIT	13,486.00 €
VII	PUNIMET E DRYNARIS	1,959.25 €
VIII	PUNIMET E PAJISJET E FUSHËS SPORTIT	810.00 €
IX	PUNIMET E SHENJIZIMIT TË SPORTEVE TË VOGLA	400.94 €
X	PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE TË NDIQIMIT	2,389.70 €

XI	PUNËT E INSTALIMEVE TË KANALIZIMEVE ATMOSFERIKE	850.00 €
XII	PUNËT E INSTALIMEVE TË UJËSJELLESIT PËR LARJE (PASTRIME) DHE VADITJE	732.40 €
TOTALI ME TVSH		31,533.52 €



V
V
KK